



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	09.01.2013
REFERENC-Ë:	AKK
PËR/ZA/TO:	Anëtarët e Bordit të Postes dhe Telekomit të Kosovës – PTK
CC:	z. Besim Beqaj, Ministër - Ministria e Zhvillimit e Ekonomik Njësia për monitorimin e ndërmarrjeve publike në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik
NGA/OD/FROM:	z. Hasan Preteni, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë

Të nderuar,

Me datën 06.07.2012 Agjencia kundër Korrupsionit ka nxjerr vendim lidhur me rastin me nr. AKK-03-680/12 për z. Ejup Qerimi i cili është gjendur në Konflikt të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, pasi që ka mbajtur dy pozita publike në kundërshtim me ligjin nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

Agjencia kundër korrupsionit me datën 26.07.2012 me nr 01-2627/2012 ka kërkuar nga bordi i drejtorëve të Postes dhe Telekomit të Kosovës- PTK, kërkesën për fillimin e procedurës për shkarkim të zyrtarit të lartë z. Ejup Qerimi nga pozita e Kryeshefit Ekzekutiv të Postes dhe Telekomit të Kosovës.

Agjencia duke u bazuar në ligjin e cekur me lartë ka iniciuar procedurën kundërvajtësve me datën 07.08/2012 me nr. 01-2626/2012 në Gjykatën Komunale për Kundërvajtje në Prishtinë. Gjykata e lartpërmendur ka nxjerr aktvendim me të cilin e shpall përgjegjës z. Ejup Qerimi për shkelje të ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

Po ashtu edhe gjykata e lartë për kundërvajtje si gjykatë e shkallës së dytë, pas ankesës së paraqitur nga i pandehuri kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë, me datën 10.12.2012 me nr. 1195/2012 ka nxjerr aktvendim me të cilin vërteton aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë sa i përket gjobës së shqiptuar dhe kundërvajtjes së kryer.

Andaj duke u bazuar në kërkesën e datës 26.07.2012 të bërë nga Agjencia kundër Korrupsionit kërkojmë nga ju si mbikëqyrës të merrni masat e duhura konform nenit 18 pika 8, 9 dhe 11 të ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

Bashkangjitur gjeni vendimin e Gjykatës së lartë për kundërvajtje si gjykatë e shkallës së dytë dhe përfundimtare, dhe kërkesën e Agjencisë për fillimin e procedurave për shkarkim të zyrtarit në fjalë.

Me respekt!

GJ.L. Nr. 1195/2012

DPK/OPKI

03-4576/12

01

21.12.2012

GJYKATA E LARTË PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Mejreme Zekaj kryetare, Dalip Bega dhe Ramiz Kuqi anëtarë, me pjesëmarrjen e Sek. juridike Nexhmije Abazxhik, duke vendosur sipas ankesës së paraqitur nga mbrojtësi-avokati Elmi Qerimi nga Gjilani, për të pandehurin Ejup Qerimi nga Fushë Kosova, kundër aktvendimit të Gjykatës Komunale për Kundërvajtje në Prishtinë, Nr. regj. 32186/2012 të dt. 15.10.2012, në bazë të nenit 31 al. 3, 39 konform të nenit 220 dhe 221 të Ligjit mbi kundërvajtjet, më dt. 10.12.2012, merr këtë.

A K T V E N D I M

VËRTETOHET aktvendimi i Gjykatës komunale për kundërvajtje në Prishtinë, Nr. regj. 32186/2012 të dt. 15.10.2012., sa i përket kundërvajtjes së kryer dhe gjobës së shqiptuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj, ndërkaq NDRYSHOHET aktvendimi i goditur në pjesën që ka të bëjë me shqiptimin e masës mbrojtëse, ashtu që i pandehuri Ejup Qerimi nga Fushë Kosova, lirohet nga masa mbrojtëse Ndalimi i ushtrimit të funksionit publik në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajsh.

Nga një kopje të këtij aktvendimi duhet dorëzuar palëve.

A R S Y E T I M

Gjykata Komunale për Kundërvajtje në Prishtinë, sipas aktvendimit Nr. regj. 32186/2012 të dt. 15.10.2012, të pandehurin Ejup Qerimi nga Fushë Kosova, e ka shpall përgjegjës sepse: më dt. 24.02.2012, kur është zgjedhur në funksionin e Kryeshëfit Ekzekutiv të PTK-së, është gjendur në pozitën e konfliktit të interesit nga se i njëjti ishte duke e ushtruar funksionin e Anëtarit të Bordit Udhëheqës të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, dhe atë nga dt. 18.06.2011.

Ushtrimi i këtyre dy funksioneve publike në Organizatat Ëmprimprurëse siç është PTK-ja dhe Organizata jofitimprurëse siç është Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës, si Menaxhues apo anëtar i Organit Menaxhues e kanë vu të pandehurin në situatë të konfliktit të interesit, më ç,veprim i pandehuri ka kryer kundërvajtje nga neni 16 par. 1 e sanksionuar me nenin 20 par. 1.1 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik me nr. 04/1-051 dhe i është shqiptuar gjoja në shumë prej 2000 (dymijë) Euro.

Me të njëjtin aktvendimi pandehuri është i obliguar që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 15 (pesëmbëdhjetë) Euro

Konform të nenit 20.2 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik të pandehurit i shqiptohet masa mbrojtëse Ndalimi i ushtrimit të funksionit publik në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajsh, nga dita kur ky aktvendim të bëhet i plotfuqishëm.

Ekzekutimin e kësaj mase do ta bëjnë organet të cilat e kanë zgjedhur të pandehurin në pozitë të lartë cekura gjegjësisht Bordi Udhëheqës i PTK-së, dhe Kuvendi i Kosovës.

Kundër këtij aktvendimi mbrojtësi-avokati Elmi Qerimi, ka paraqitur ankesë për të pandehurin Ejup Qerimi, për shkak të:

- shkeljes thelbësore të rregullave të procedurës,
- vërtetimit të jo të plotë dhe jo të drejtë të gjendjes faktike dhe
- zbatimit të gabuar të dispozitave materiale dhe Ligjit.

2.

Me arsyetim se dispozitivi i aktvendimit është i pakuptueshëm dhe kontradiktor me vet veten dhe me arsyet e aktvendimit, nga se nuk ka treguar asnjë fakt vendimtar në të cilin është mbështetur dhe si i tillë nuk është i qartë juridikisht. Nuk mund të kuptohet se me cilat veprime i pandehuri e ka kryer veprën kundërvajtëse, nga se sipas Ligjit në fjalë konflikt interesi përfshinë një konflikt midis detyrës publike dhe interesave private. Bordi i Drejtorëve të PTK-së, e ka marr opinion legal ku është konstatuar se tek unë si Kryeshef Ekzekutiv në PTK, nuk ekziston konflikti interesit në asnjë situatë dhe se AKK, nuk ka prezantuar kurrfarë fakti me të cilin dëshmohet se eksiton gjendja e konfliktit të interesit. Gjykata e shkallës së parë nuk e ka cek se si është identifikuar Konflikti i Interesit për të dhënë vendimin meritot, por vetëm i cek pozitat menaxhuese. Shton se e kam një punë të rregullt me kontratë në PTK, ndërsa si Anëtar i Bordit Drejtues të Trustit Pensional jam i angazhuar në punë me honorar e cila nuk është e përditshme dhe e rregullt, se pagën të cilën e realizoj si Kryeshef Ekzekutiv në PTK-së, është pagë e ligjshme, kështu që nuk qëndron konstatimi i gjykatës se i kam dy pozita të karakterit menaxherial me orar të plotë të punës. Gjykata e shkallës së parë provat të cilat i ka nxjerrë nuk i ka vlerësuar në mënyrë të gjithë anshme, andaj nuk është vërtetuar gjendja faktike. I propozon Gjykatës së lartë për Kundërvajtje në Prishtinë, që të aprovohet ankesa dhe të anulohet aktvendimi i Gjykatës së shkallës së parë.

Kolegji i kësaj gjykate duke i vlerësuar thëniet në ankesë, aktvendimin e goditur, dhe shkresat tjera të lëndës, konstatoi se ankesa e paraqitur sa i përket veprës kundërvajtëse dhe gjobës së shqiptuar është e pabazuar, kurse sa i përket shqiptimit të masës mbrojtëse është e bazuar.

Nga provat e deponuara dhe të administruara në gjykatën e shkallës së parë, në bazë të deklaratës së dhënë të pandehurit Ejup Qerimi në seancën e shqyrtimit kryesor pranë Gjykatës së shkallës së parë, në procesverbal të dt. 08.10.2012, dëshmisë së dëshmitarit Frasher Murtezaj zyrtar i lartë për konfliktit të interesit, në procesverbal të dt. 09.10.2012; Referencës-njoftim të AKK të dt. 02.04.2012, me nr. DPK-680/2012; Vendimit të Agjencisë Kundër Korrupsionit të dt. 05.07.2012; Opinionit Legal dhe Rekomandimit Konkret për Veprim të Bordit të Drejtorëve PTK-ës SHA të dt. 30.08.2012 me nr. 05-4424/2012; Aktit të emërimit të Ejup Qerimit si Anëtarë i Bordit Udhëheqës i Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës të dt. 17.06.2011, si dhe nga shkresat tjera të lëndës, pa dyshim është vërtetuar gjendja faktike se i pandehuri është përfshirë në pa pajtueshmëri gjatë ushtrimit të funksionit publik të zyrtarit të lartë dhe funksionit menaxherial në të njëjtën kohë, me çka ka kryer kundërvajtje për të cilën mban përgjegjësi kundërvajtëse, andaj sa i përket ekzistimit të veprës kundërvajtëse dhe gjobës së shqiptuar nuk ka bazë për ndryshimin apo abrogimin e aktvendimit të goditur.

Kolegji konstatoj se gjykata e shkallës së parë drejtë e ka vërtetuar gjendjen faktike se i pandehuri e ka kryer kundërvajtjen për të cilën mban përgjegjësi kundërvajtëse, duke u bazuar në atë se i pandehuri gjersa ishte duke e ushtruar funksionin e zyrtarit të lartë publik nga dt. 18.06.2011, si Anëtar i Bordit Udhëheqës të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, është emëruar edhe Drejtor Ekzekutiv në PTK-ës më dt. 24.02.2012-në postë menaxherial, dhe nga kjo datë është përfshirë në papajtueshmëri gjatë ushtrimit të funksionit të zyrtarit të lartë publik, e cila padyshim konsiderohet si njëra prej formave të konfliktit të interesit.

3.

Gjersa sa iu përket pretendimeve të të pandehurit të paraqitura në ankesën e parashtuar, se në rastin konkret nuk ka konflikt interesi, duke u bazuar në relacionin e konfliktit të interesit publik me atë privat dhe se posti i Anëtarit të Bordit Drejtues të Trustit të Kursimeve Personale të Kosovës, të cilin e ushtron i pandehuri, nuk është post menaxherial duke e kontestuar kështu edhe konstatimin e gjykatës së shkallës së parë të dhënë në arsyetimin e aktvendimit të goditur-se i pandehuri në të njëjtën kohë i mban dy poste menaxheriale- janë konsideruar si të pa baza për shkak se:

- në rastin konkret nuk bëhet fjalë për relacionin e konfliktit të interesit publik-privat, por për konfliktin gjatë ushtrimit të funksionit të zyrtarit të lartë publik i cili në të njëjtën kohë e kryen edhe funksionin e menaxhuesit-Drejtor Ekzekutiv në PTK, me çka ka rëndësi me nenin 16 par. 1. të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik,

- gjersa sa i përket pretendimit se njeri prej posteve që e ushtron i pandehuri nuk është post menaxherial, është konstatuar se i pandehuri është shpallur përgjegjës për shkak se si Zyrtar i Lartë Publik në Trustin Pensional të Kosovës, e ushtron edhe postin Menaxhues-Drejtor Ekzekutiv në PTK, andaj mbajtja e dy posteve menaxheriale në rastin konkret, nuk është çështje e ngritur për tu vlerësuar.

Në këtë drejtim duhet potencuar edhe atë se gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktvendimit të goditur, pa arsye e ka marrë për bazë, përveç tjerash edhe faktin se i pandehuri gjëja i mban dy poste menaxheriale, pasi që në rastin konkret, nuk është çështje e ngritur për tu vlerësuar.

Si rrjedhojë e të cekurave më lartë pretendimet e të pandehurit të paraqitura në ankesën e parashtuar janë hüdë poshtë si të pa baza, duke i konsideruar si përpjekje për të ikur përgjegjësisë kundërvajtëse.

Andaj konstatohet se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vepruar kur të pandehurin e ka shpall përgjegjës dhe e ka gjobitur sipas nenit 16 par. 1 e sanksionuar me nenin 20 par. 1 pika l. 1. të Ligjit për parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, i cili në mënyrë decisive i ndalon zyrtarit të lartë publik që të jetë menaxhues ose anëtarë i organeve menaxhuese në organizata fitimprurës dhe jofitimprurës.

Ndërkaq duke u bazuar në faktin se neni 20 p. 2 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, parasheh edhe shqiptimin e masës mbrojtëse e cila është paraparë si mundësi e jo obligim ligjor, kurse parashtuesi i Kërkesës për iniciimin e procedurës kundërvajtëse, nuk ka propozuar me kërkesë që ndaj të pandehurit Ejup Qerimi, të shqiptohet një masë e tillë, është konstatuar se nuk janë plotësuar kushtet ligjore për shqiptimin e masës mbrojtëse, për çka aktvendimi i goditur ndryshohet dhe i pandehuri lirohet nga masa mbrojtëse, e cila konsiderohet si e pa bazuar.

Kolegji konstaton se Gjykata e shkallës së parë, gjatë zhvillimit të procedurës, nuk ka bërë shkelje të dispozitave të procedurës kundërvajtëse, përkatësisht aplikim të gabuar të drejtës materiale, kurse gjoba e shqiptuar në shumë prej 2000 (dymijë) Euro, sipas nenit 7 të LK, ndaj të pandehurit Ejup Qerimi, konsiderohet se është përcaktuar sipas shkallës së përgjegjësisë, peshës së veprës së kryer dhe rrethanave nën të cilat është kryer vepra kundërvajtëse, andaj në këtë drejtim nuk ka bazë ligjore për ndryshimin apo abrogimin e

03-4576/12/04
dij

4.

aktvendimit të goditur. Ndërkaq sa i përket masës mbrojtëse të shqiptuar nga Gjykata e shkallës së parë Ndalimi i ushtrimit të funksionit publik në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajsh, e njëjta është konsideruar si e pa bazuar, për çka në këtë drejtim ndryshohet aktvendimi i goditur ashtu që i pandehuri Ejup Qerimi lirohet nga masa mbrojtëse, duke konsideruar se gjoba e shqiptuar do të ndikoj në masë të mjaftuar që i pandehuri në të ardhmen mos të kryej kundërvajtje të tilla apo të ngjashme.

Andaj konform të nenit 220 dhe 221 të LK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Kundër këtij aktvendimi nuk ka vend ankese.

GJYKATA E LARTË PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË.

GJ.L. Nr. 1195/2012 të dt. 10.12.2012.

SEK. JURIDIKE,
Nexhmije Abazxhik



KRYETARE E KOLEGJIT,
Mejreme Zekaj

(Handwritten signature)



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCİJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

REPUBLIC OF KOSOVO REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
AGENCIJA PROTIV KORRUPCİJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Nr. Prot. 01-2627/12
Prot. No. 01-2627/12
Data 26-07-2012
Date 26-07-2012

Nr. 02

DATË/A:	25.07.2012
REFERENC-Ë:	AKK-DP-03/11
PËR/ZA/TO:	Bordit të Drejtorëve të PTK-së
CC:	z. Besim Beqaj – Ministër i Zhvillimit Ekonomik.
CC:	Njësia për monitorimin e ndërmarrjeve publike në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	z. Hasan Preteni – Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit.
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesa për fillimin e procedurave për shkarkim



Të nderuar,

Duke u bazuar në nenin 18, pika 8. të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik (Nr.04/L-051), si dhe në Nenin 29.2. të Ligjit Kundër Korrupsionit (Nr.2004/34) ju shkruajmë me kërkesen që :

Të filloni procedurën për shkarkimin e zyrtarit të lartë z.Ejup Qerimi, nga pozita e Kryeshefit Ekzekutiv në Posten dhe Telekomin e Kosovës, për shkak se i njejtë njëkohësisht ushtron edhe funksionin e zyrtarit të lartë, në cilësinë e Anëtarit të Bordit, në Trustin Pensional të Kursimeve të Kosovës, e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, ushtrimi i njëkohëshëm i këtyre dy funksioneve paraqet konflikt interesi.

Po ashtu, në pajtim me Neni 18 pika 11 të Ligjit Nr.04/L-051, dhe Neni 29.3 të Ligjit Nr.2004/34, kërkojmë nga ju që të na informoni për vendimin tuaj final lidhur me këtë rast.

Arsyetim:

I gjithë rasti është inicuar me kërkesen e vet personit zyrtar, ztr. Qerimi, i cili në një shkresë zyrtare të datës 28.02.2012, ka kërkuar nga Agjencia kundër Korrupsionit sqarime dhe interpretim ligjor për situatën e tij të mundshme si konflikt interesi.

Bazuar në Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik (Neni 18 pika 1 dhe pika 5), zyrtarë të Agjencionit kundër Korrupsionit (AKK), kanë zhvilluar takim me zyrtarin e lartë Qerimi, në të cilin atij i është bërë e ditur se ushtrimi i njëkohësishëm i këtyre dy funksioneve, paraqet Konflikt interesi dhe z.Qerimi është këshilluar për mënyren e shmangies së situatës së tillë (Neni 19 pika 1.5 e Ligjit Nr.04/L-051).

Por, z.Qerimi nuk u është bindur argumenteve të AKK-së dhe nuk i ka pranuar rekomandimet e AKK-së. Këtë e dëshmon me shkresën e tij kthyesë si "Përgjigje lidhur e njoftimin për fillimin e procedurës së shqyrtimit të gjendjes së konfliktit të interesit me nr.01-1361/2012".

Agjencia kundër Korrupsionit, me datën 24.05.2012, i ka dërguar z.Qerimi edhe shkresën e dytë, që njihet si "Paralajmërim", në të cilën është theksuar se ushtrimi i njëkohësishëm i dy funksioneve, si Anëtar i Bordit të Drejtorëve të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, dhe pozitës së Kryeshefit Ekzekutiv në Postën dhe Telekomin e Kosovës (PTK), paraqesin konflikt interesi.

Në këtë shkresë nga zyrtari i lartë, Z.Qerimi, është kërkuar që për të shmangur konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik, ai të heq dorë nga ushtrimi i njërit nga këto dy funksione publike, d.m.th të zgjedhë për vetëm njëren nga to dy funksione.

Edhe pas shkresës sonë të dytë dhe afatit të dhënë, për të shmangur këtë situatë të papajtueshme, zyrtari Qerimi, nuk ka bërë asnjë ndryshim në shmangien e konfliktit të interesit.

Zyrtari Ejup Qerimi vazhdon të ushtroj akoma këto dy funksione publike, një si Anëtar i Bordit të Drejtorëve në Trustin Pensional të Kosovës (si përfuqësues i punëdhënësve) në njerën anë, dhe në anën tjetër, Kryeshef Ekzekutiv i Postës dhe Telekomit të Kosovës (PTK-së), që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik,(Nr.04/L-051), konsiderohen të papajtueshme dhe paraqesin konflikt interesi.

Prandaj, gjithmon duke ju referuar Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funkcionit Publik dhe Ligjit kundër korrupsionit, Agjencia kundër Korrupsionit ju bënë kërkesën si në dispozitiv.

Me respekt,

